



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.357/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektori i Punes, me seli ne Prishtinë, kundër debitorit NGB “Zëri” shpk me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.850/23 të datës 26.10.2023, me datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit NGB “Zëri” shpk me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë KPPP.nr.850/23 të datës 26.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.850/23 të datës 26.10.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit NGB “Zëri” shpk me seli ne Prishtinë dhe ka lene ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.96/23 te datës 15.05.2023, te lejuar nga përmbaruesi privat Driton Govori.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e shkalles se parë ta prish dhe çështja te kthehet ne shkalle te parë ne rivendosje .

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje ne ankesë

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 15.05.2023, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përbarues Vendimit nr.01 Nr.09-132-V-483/2022 i dt.21.10.2022 me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të ndëshkimit administrativ për shkeljen e nenit 17 par.2 të Ligjit të Punës e sanksionuar me nenin 72 të Ligjit të Punës, bazuar në nenin 12 të UA. Nr.07/2012 për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës, t'ia paguaj shumën prej 4.100.00 EUR e pesëqind euro) € si dhe të paguhen shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifat në fuqi..

Kundër urdhrin përbarimor debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor me arsyetimin dokumenti i pretenduar përbarimor është bere i formës se prere ende pa u pranuar nga ane debitorit, përkatësisht pa i dhënë mundësin dhe te drejtën e ankesës, si dhe i njëjti nuk përmban te gjitha elementet e vendimit, si dhe per faktin se dokumentin përbarimor te atakuar nuk është konstatuar drejte gjendja faktike.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkalles se Parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar për shkaqet si në vijim: Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se: “Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.” Ndërsa, me nenin 22, par.1 nën-par 1.2 përcaktohet se: 1. Dokumente përbaruese janë: ... 1.2. vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi (më tej: ujdia)”.

Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar dokumentin– Vendim i Inspektorati i Punës me Vendimit nr.01 Nr.09-119/2022 i dt.18.07.2022 në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata tutje gjeti se Vendimi i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “Dokumentit përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Dhoma e shkallës së parë gjeti se vendimi i lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e

vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”, ngase i njëjti është bërë i formës së prerë me datë 09.08.2022 dhe i ekzekutueshëm prej datës 09.08.2022.

Tutje dhoma e shkallës së parë me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e debitorit se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka marrë formën e prerë, pasi që ende nuk është vendosur në lidhje me ankesën e tij, por që këtë pretendim e vlerësoj si të paqëndrueshëm për faktin se në kuptim të nenit 6.4 të Ligjit nr. 2009/9 për Inspektoratin e Punës, ankesa ndaj vendimit nuk e shtyen ekzekutimin, andaj përmbarimi është lejuar në përputhje me nenin 24, par.5 të LPP-së i cili parasheh se “Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin”.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i Inspektorati të Punës me nr.01 Nr.09-119/2022 i dt.18.07.2022, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “*Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është ne pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, ngase i njëjti është bere i formës se prerë me datën 12.04.2023 dhe i ekzekutueshëm prej datës 12.04.2023 ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “*Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë*”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim. Arsye këto nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë te paargumentuara dhe si te tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative, te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II.nr.357/24 me datë 04.06.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami